



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.118/1 dt.29.10.2001

**MBI
MIRATIM DHENIE ME QERA SHOQËRISË “EURODRURI” SH.P.K DHE
“METAL-PLAST” SH.P.K**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 neni 32, gërma e, “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, Ligjit Nr.8654 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Tiranë”, V.K.M. Nr.430 dt.09.07.1998 “Për dhënien me qera të objekteve të Ndërmarrjeve, Shoqërive e Institucioneve Shtetore”, pika 1, gërma b, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I

1. Të miratojë dhënien me qera të objektit Reparti i Galvanizimit në Ndërmarrjen Metalike Tirana me sipërfaqje 441 m², sipas genplanit bashkëlidhur shoqërisë “EURODRURI” sh.p.k për një periudhë 5-vjeçare
2. Të miratojë dhënien me qera të objektit Reparti i Galvanizimit me sipërfaqje 440 m² në Ndërmarrjen Metalike Tirana sipas Gen-planit bashkëngjitur, shoqërisë “METAL-PLAST” sh.p.k për një periudhë 5-vjeçare
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria Juridike

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA

